



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural / Ministarstvo Poljoprivrede,  
Šumarstva i Ruralnog Razvoja / Ministry of Agriculture, Forestry And Rural Development  
Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë / Agencija za Razvoj Poloprivrede / Agriculture Development Agency

Në bazë të Ligjit Nr. 06/L – 114 për zyrtarët publikë, Neni 38 (1,2,3 dhe 4) dhe Rregullores (QRK) NR. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovë, Neni 40 Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural- Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë shpall:

## Konkurs

### Lëvizje brenda kategorisë

*Të drejtë për aplikim në këtë procedure kanë vetëm nëpunësit civil ekzistues të së njëjtës kategori të punësuar në të njëjtin apo në një tjetër institucion të shërbimit civil.*

<b>Titulli i pozitës së punës</b>	Zyrtar i Lartë i Personelit
<b>Klasa e pozitës</b>	Profesional 1
<b>Koeficienti/Paga</b>	8
<b>Nr. i kërkuar</b>	1
<b>Data e njoftimit</b>	01/02/2023
<b>Afati për aplikim</b>	17/02/2023 - 02/03/2023
<b>Institucioni</b>	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural- Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë
<b>Departamenti</b>	Drejtorati për Administrat të Përgjithshme
<b>Divizioni</b>	
<b>Vendi i punës</b>	Prishtine
<b>Nr. i Referencës</b>	RN00010831
<b>Kodi</b>	RPC0004493



## 1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

---

1. Asiston në zhvillimin e politikave dhe procedurave të personelit për të siguruar se organizata ndjek praktikat më të mira;
2. Përgatitë dhe bënë shpalljen e konkurseve për pozita të lira pune;
3. Propozon komisionet e intervistimit dhe vlerësimit, zhvillon procesin e rekrutimit, monitoron, vlerëson për të siguruar se institucioni rekruton njerëzit më të mirë për pozitat e shpallura në përputhje me legjislacionin dhe praktikat më të mira që kanë të bëjnë me mundësitë e barabarta dhe konkurruese;
4. Mirëmbanë të gjitha regjistrat e nevojshem të personelit për të monitoruar efektivisht nivelin e ndryshimeve/plotësimeve;
5. Ofron këshilla për menaxheret për një varg të çështjeve të punësimit për të siguruar që të menaxhojnë me stafin në përputhje me praktikat më të mira dhe kërkesat ligjore;
6. Përgatitë shkresa, politika dhe dokumente të tjera që kanë të bëjnë me kushtet dhe kërkesat e punësimit për të siguruar që institucioni punon në përputhje me kërkesat ligjore;
7. Pas konsultimit me Udhëheqësin e divizionit të Personelit, përzgjedh dhe klasifikon nëpunësit për trajnime të ndryshme, sipas profilit të tyre;
8. Ofron përkrahje dhe këshilla për menaxheret në planifikimin e kërkesave të nëpunësve;
9. Analizon kërkesat e vendeve të punës dhe përgatitë përshkrime të detyrave dhe specifikacionet e personave për rekrutim dhe ata që janë rekrutuar, vlerësimin në punë dhe qëllime të tjera;
10. Kryen detyra të tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret momentale, të cilat me arsyeje mund të kërkohen kohë pas kohe

## 2. Kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta

---

- Të jetë nëpunës civilë i të njëjtës kategori për të cilën aplikon.
- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar në detyrë në rastin e lëvizjes brenda kategorisë profesionale.
- Të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende.
- Të jetë vlerësuar të paktën 'mirë' për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit.
- Në rastin e konkurimit për lëvizje brenda kategorisë profesionale të jetë vlerësuar të paktën mirë në vitin e fundit.

## 3. Kërkesat e përgjithshme formale

---

- Arsimimi i kërkuar: Fakulteti Administratë Publike, Juridik ose Ekonomik
- Kualifikime të posaçme formale: Certifikata të trajnimeve
- Përvoja e punës e kërkuar: Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.



## 4. Kërkesat (Njohuri, Aftësi dhe Cilësi) e përgjithshme të nevojshme

---

- Njohuri të thellë dhe të specializuara në fushën profesionale specifike;
- Nivel të lartë të njohurive profesionale ose teknike të fushës përkatëse dhe të kuptuarit e fushave që ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësit;
- Njohuri të gjera të fushës, të metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike;
- Aftësi të arsytimit logjik dhe analizës;
- Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar.

## 5. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim

---

- Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore
- Kopjet e dëshmisë së punësimit
- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve
- Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit
- Dokument që dëshmon se nuk keni ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende

## 6. Data e daljes së rezultateve të vlerësimit paraprak

---

- Lista e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për lëvizje brenda kategorisë do të shpallet më së largu deri më datën 09/03/2023, në portalin e rekrutimit elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net> )

## 7. Data, vendi dhe ora ku do të zhvillohet intervista me gojë

---

- 23.03.2023, Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, kompleksi " Ramiz Sadiku", ora 10:00

## 8. Fusha e njohurive, aftësive dhe cilësive që do të vlerësohen në intervistën me gojë

---

1. Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar
2. Njohuri të thella dhe të specializuara në fushën profesionale specifike
3. Nivel të lartë të njohurive profesionale ose teknike të fushës përkatëse dhe të kuptuarit e fushave që ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësitë.
4. Njohuri të gjera të fushës, të metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike.

## 9. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

---

- Intervist

## 10. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

---

- Përmes email dhe portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

## 11. Mënyra e aplikimit

---

- Përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)



## 12. Data e shpalljes së rezultateve përfundimtare

---

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

### Të dhëna shtesë:

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

